



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 240, Datë 30.09.2025

MBI

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 29, DATË
03.02.2025 “MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “MER ENERGJI” SH.P.K. NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; nenit 113 të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15, të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.09.2025, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, me nr. 2081/3 prot., datë 26.09.2025 “Mbi disa ndryshime në vendimin e bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025 “Mbi licencimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, **Konstatoi se:**

1. Të dhënat mbi shoqërinë “MER ENERGJI” sh.p.k.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 29, datë 03.02.2025, ka miratuar licencën e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentrali “Faëkuqi 3”, me kapacitet të instaluar 1300 kW, me vendodhje në Fshatin Vlush, Bashkia Skrapar, Qarku Berat, me afat deri më 16.10.2053. Vendimi parashikon që, shoqëria duhet të fillojë operimin/ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda datës 14.05.2025 dhe nga fillimi operimit, jo më vonë se 60 (gjashtëdhjetë), shoqëria duhet të dokumentojë në ERE testimin e veprës, dhe se vendimi mund të rishikohet në funksion të këtyre plotësimeve.

2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria

- Shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k., me shkresën e datës 14.07.2025, protokolluar në ERE me nr. 2081 prot., datë 14.07.2025, ka paraqitur një njoftim mbi fillimin e operimit të hidrocentralit “Faëkuqi 3”, duke bërë me dije se për shkak të mungesës së prurjeve ujore nuk mund të realizohej testimi me ngarkesë të plotë.
- Në vijim të kësaj, shoqëria ka depozituar pranë ERE-s: shkresë e OSSH sh.a.me nr. 6897/1 Prot., datë 04.07.2025, raportimet periodike mbi ecurinë e punimeve drejtuar MIE dhe AKBN të datave 11.10.2024; 13.01.2025; 07.04.2025 dhe 03.07.2025, në funksion të përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në pikën 2 të këtij vendimi.

- Gjithashtu, shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k. me shkresën e datës 10.09.2025, protokolluar në ERE me nr. 2435 Prot., datë 10.09.2025, ka paraqitur në ERE kërkesën për heqjen e kushteve të licencimit, për përfundimin me sukses të ndërtimit dhe testimit në prani të AKBN të HEC “Faqekuqi 3”. Depozitimi i raportit për testimin e veprës përmbush kushtin e përcaktuar në pikën 3 të vendimit të sipërpërmendur.

3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 10 të kontratës koncensionare nr. 2183 rep., nr. 1145/1 kol., datë 16.10.2018, të ndryshuar, përcaktohet se Koncensionari merr përsipër të vërë në punë hidrocentralin, brenda 12 muajve nga marrja e të gjitha lejeve për fillimin e punimeve. Në kushtet kur koncesionari, ka paraqitur periodikisht raportet e ecures së punimeve pranë Autoritetit Kontraktor dhe është bërë testimi i veprës nga AKBN me njoftim edhe të MIE, vlerësojmë që mosplotësimi i këtij kushti nga ana e tij, nuk përbën shkak për pengimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, për sa kohë nuk ka një qëndrim ndryshe nga ana e Autoritetit Kontraktor.

4. Nevoja për Ndryshimin e Vendimit

- Në funksion të sa parashtruar me sipër, vlerësohet se kushti i vendosur në pikën 2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025, “Mbi licencimin e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”, nuk përbën shkak për pengimin e ushtrimit të veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike, dhe si i tillë duhet të shfuqizohet nga Enti Rregullator i Energjisë. Për çdo rast që Autoriteti Kontraktor do të ketë një qëndrim ndryshe për mënyrën e ushtrimit të veprimtarisë në prodhimin e energjisë elektrike, vlerësohet të ndryshohet pika 4 e vendimit nr. 29/2025, e cila do të formulohet si vijon: *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga atë që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”*.
- Përsa i përket kushtit të vendosur në pikën 3 të vendimit nr. 29/2025, është përmbushur nga ana e shoqërisë “MER ENERGJI” sh.p.k., prandaj duhet të shfuqizohet.
- Bazuar në nenin 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ku përcaktohet se një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, kryesisht nga organi publik që ka kompetencë të nxjerrë aktin, nga organi i tij epror apo nga një organ tjetër i parashikuar shprehimisht me ligj, vlerësojmë që pika 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025, duhet të shfuqizohet pasi shoqëria “MER ENERGJI” sh.p.k. ka përmbushur kushtin e vendosur nga ERE.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Pikat 2 dhe 3 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025, shfuqizohen.

2. Pika 4 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 29, datë 03.02.2025, ndryshon dhe bëhet: *“Ky vendim është objekt rishikimi, në rast të depozitimit të akteve të ndryshme nga ato që kanë shërbyer për marrjen e këtij vendimi”*.
3. Drejtoria e Politikave të Burimeve të Rinovueshme, të njoftojë shoqërinë “MER ENERGJI” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, FTL sh.a. dhe ALPEX sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI